DIFFERENT & EQUAL
TE NDRYSHEM & TE BARABARTE

RAPORTI VJETOR 2015

PËRMBAJTJA

I. **Projektet e zbatuara gjatë 2015 dhe donatorët**

II. **Përfituesit e programit**

   a. ***Profili i rasteve VeT / VMT***
   b. ***Profili i rasteve viktima të dhunës në familje***

III. **Shtyllat kryesore të punës së D&E gjatë vitit 2015**

- ***Asistencë direkte për vajzat dhe gratë viktima të abuzimit, trafikimit dhe dhunës në familje***
- ***Kontributi në kthimin e asistuar të viktimave të trafikimit, VMT apo viktima të dhunës në familje***
- ***Asistencë direkte për meshkuj viktima të abuzimit, trafikimit dhe dhunës***
- ***Rritja e përpjekjeve për identifikimin e viktimave /viktimave të mundshme të trafikimit***
- ***Rritja e përpjekje për fuqizimin ekonomik të viktimave të trafikimit***
- ***Avancimi i bashkëpunimit me ofruesit e shërbimit dhe me institucionet shtetërore lokale***
- ***Aktivitete ndërgjegjësuese për trafikimin***
- ***Aktivitete për parandalimin e dhunës seksuale***

IV. **Trainime dhe prezantime të ofruara nga D&E**

V. **Pjesëmarrja e stafit në trainime**

VI. **Koordinime me Aktorë të tjerë Kundër Trafikimit**

VII. **Botime të D&E**

I. PROJEKTET E ZBATUARA GJATË 2015

Projekti 1: "Rritja e përpjekjeve për riintegrimin e viktimave të trafikimit në Shqipëri"
Donator: Pro Victims
Kohëzgjatja: - Pro Victims 1 Tetor 2014 – 30 Shtator 2016

Projekti 2: "Sigurimi i asisitencës riintegruese të qëndrueshme për Viktimat e Trafikimit dhe atyre në risk trafikimi"
Donator: UNODC
Kohëzgjatja: - Prill 2015 – Mars 2016

Projekti 3: "Anti-Trafficking in Persons: Training of Trainers and Community Education Program", në bashkëpunim me US Peace Corps Albania Anti-Trafficking in Persons Committee (ATIP).
Donator: Ambasada Amerikane në Tiranë
Kohëzgjatja: 2014 – 2015 (12 muaj)

Projekti 4: "Qendër për aktivitete edukative për Viktimat e Trafikimit"
Donator: Mary Ward Loreto
Kohëzgjatja: 2 vjet (vazhdon)

Projekti 5: "Cikli i këshillimit"
Donator: Swiss Contact
Kohëzgjatja: në vazhdimësi

Projekti 6: "Rritja e përpjekjeve riintegruese për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri dhe ofrimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese për personat në nevojë dhe profesionistët kyç"
Donator: Renovabis
Kohëzgjatja: November 2014 – October 2017 (3 vjet)

Projekti 7: "Informimi i komunitetit mbi trafikimin e grave dhe vajzave dhe zgjedhjet alternative"
Donator: UN WOMEN
Kohezgjatja: Shtator 2015 – Shkurt 2016

Projekti 8: "Our Voices"
Donator: University of Bedforshire
Kohezgjatja: 2013-2016

II. PËRFITUESIT E PROGRAMIT

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2015 janë asistuar në programin riintegrues të organizatës 113 përfituese dhe 81 fëmijë të tyre nga të cilat 56 raste dhe 45 fëmijë kanë hyrë për herë të parë në program gjatë kësaj periudhe, ndërsa rastet e tjera janë të mbartura nga viti i kaluar dhe kanë vazhduar të marrin ndihmë sipas planit të riintegrimit.

Nga totali i përfitueseve, 90 raste të asistuara në programin e D&E kanë qenë vktima / viktima të mundshme trafikimi dhe 32 fëmijë të tyre. Nga këto 41 raste dhe 16 fëmijë të tyre kanë qenë raste të reja VT / VMT të hyra në program gjatë kësaj periudhe.

23 rastet e tjera të asistuara në programin e D&E kanë qenë viktima të dhunës në familje dhe abuzimit dhe 49 fëmijë të tyre.

Kategoritë e përfitueseve të asistuara në program

Kategori	Total i rasteve të asistuara në program gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015	Rastet e mbartura nga Dhjetor 2014	Rastet e reja në program gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015
Viktima trafikimi / Viktima të mundshme trafikimi	90	49	41
Fëmijë të VeT shoqëruar me nënat e tyre	32	16	16
Viktima të dhunës dhe abuzimit	23	8	15
Fëmijë të VeDH shoqëruar me nënat e tyre	49	20	29
Totali	**194**	**93**	**101**



- ***PROFILI I RASTEVE VIKTIMA / VIKTIMA TË MUNDSHME TRAFIKIMI***

Gjinia

Gjinia	Numri i rasteve të mbartura	Numri i rasteve të reja	Total
Femra	32	35	67
Meshkuj	17	6	23
TOTAL	**49**	**41**	**90**

Mosha

Mosha	14-17	18-25	26-30	31-35	Mbi 36	Total
Numri i rasteve	19	13	2	5	2	**41**
Përqindja	46%	32%	5%	12%	5%	**100%**



Mënyrat e rekrutimit



Vendi ku kanë qenë trafikuar

Vendi ku janë shfrytëzuar	**Nr i rasteve**
Shqipëri	25
Itali	2
Zvicër	1
Gjermani	3
Shqipëri/ Greqi	2



Format e shfrytëzimit



Referimet e rasteve sipas muajve

41 raste të reja VeT dhe 16 fëmijë kanë hyrë në program gjatë kësaj periudhe.

Muaji	Nr i rasteve të referuara	Nr i fëmijëve
Janar	2	2
Shkurt	3	1
Mars	5	2

Prill	4	3
Maj	1	0
Qershor	2	1
Korrik	4	0
Gusht	1	1
Shtator	6	3
Tetor	7	2
Nëntor	4	0
Dhjetor	2	1
Total	**41**	**16**

Burimi i referimit për rastet e reja të asistuara gjatë Janar – Dhjetor 2015:

Burimet e referimeve	**Nr. i rasteve**
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	2
Drejtoria e Plicisë - Tiranë	2
Drejtoria e Policisë - Berat	1
Drejtoria e Policisë - Durrës	2
Drejtoria e Policisë, dhe Bashkia Rrëshen	2
Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit	1
Komisariati i Policisë nr.2	1
Komisariati i Policisë nr.3	1
QKPVT	3
Shoqata "Tjetër Vizion", Elbasan	2
Qendra "Vatra", Vlorë	3
Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve (Tirane, Kucove)	2
ARSIS	1
Institucione Fetare	2
SHKBSH	1
Institucion për Fëmijë, Sarandë	1
Qendra Kombëtare e trajtimit të viktimave të dhunës në familje	2
IOM Tirana	1
Njësia Lëvizëse, Tiranë	6
SOS Fshati i Fëmijëve	1
Save the Children / Fëmijët për fëmijët në situatë rruge	1
Organizata "Solwodi" në Gjermani	2
Vetëreferuar	1
TOTAL	**41**

- ***PROFILI I VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE DHE ABUZIMIT***

Gjinia

Gjinia	Numri i rasteve të mbartura	Numri i rasteve të reja	TOTAL
Femra	8	14	22
Meshkuj	0	1	1
TOTAL	8	15	23

Mosha

Mosha	18-25	26-30	31-35	Mbi 36	Total
Numri i rasteve	4	6	2	3	15
Përqindja	27%	40%	13%	20%	100%

Referimet e rasteve sipas muajve

15 raste dhe 29 fëmijë kanë hyrë në program gjatë kësaj periudhe.

Muaji	Nr i rasteve të referuara	Nr i fëmijëve
Janar	2	6
Shkurt	1	3
Mars	2	3
Prill	1	2

Maj	1	1
Qershor	3	6
Korrik	2	2
Gusht	0	0
Shtator	1	3
Tetor	0	0
Nëntor	1	0
Dhjetor	1	3
Total	**15**	**29**

Burimi i referimit për rastet e reja të asistuara gjatë Janar – Dhjetor 2015

Burimet e referimeve	**Nr. i rasteve**
Qendra Kombëtare e trajtimit të viktimave të dhunës në familje	5
Drejtoia e Përgjithshme e Policisë	1
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	1
Shërbimi Social Shtetëror	2
Strehëza për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara	1
Forumi i Gruas Elbasan	1
Dev – Aid organization	1
Aleanca LGBT	1
IOM Zvicer	1
Vetëreferuar	1
TOTAL	**15**



III. SHTYLLAT KRYESORE TË PUNËS SË D&E GJATË VITIT 2015

Aktivitetet kryesore të zbatuara nga organizata "Të Ndryshëm & Të Barabartë" për periudhën Janar - Dhjetor 2015 janë:

a. Asistencë direkte për vajzat dhe gratë viktima të abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe dhunës në familje
b. Kontributi në kthimin e asistuar të viktimave të trafikimit apo VMT
c. Asistencë direkte për meshkuj viktima të trafikimit
d. Rritja e përpjekjeve për identifikimin e VT
e. Rritja e përpjekjeve për fuqizimin ekonomik të viktimave të trafikimit
f. Avancimi i bashkëpunimit me ofruesit e shërbimit dhe me institucionet shtetërore lokale
g. Aktivitete ndërgjegjësuese
h. Aktivitiete për të parandaluar trafikimin dhe promovuar migracionin e sigurt
i. Aktivitete për parandalimin e dhunës seksuale

a. ASISTENCË DIREKTE PËR VAJZAT DHE GRATË VIKTIMA TË TRAFIKIMIT

Gjatë vitit 2015 D&E ka vazhduar të ofrojë asistencë riintegruese për viktimat e trafikimit në tre faza:
Faza #1: Ndërhyrja në situatë krize dhe Akomodimi
Faza #2: Faza tranzit e cila përfshin jetesën gjysëm të pavarur
Faza #3: Riintegrimi dhe përfshirja sociale

Një paketë e plotë shërbimesh riintegruese është ofruar për përfituesit e programit të riintegrimit të D&E: Strehim, siguri dhe plan riintegrimi; Asistencë e menjëhershme mjekësore**;** Negocim/ndërmjetësim me familjen; Vlerësime dhe këshillime psikologjike; Mbështetje dhe asistencë ligjore; Asistencë për rregjistrim / vazhdimësinë e sistemit shkollor; Trainime profesionale; Aktivitete sociale; Këshillim dhe ndihmë për punësim; Mbështetje financiare për strehim; Informacion mbi shërbimet që ekzistojnë në komunitet si dhe kontaktet e nevojshme/ harta e shërbimeve; Programe pune që krijojnë të ardhura; Asistencë dhe mbështetje për fëmijët e viktimave të trafikimit; Monitorim dhe ndjekja e mëpasshme e përfitueseve te programit.

Përveç asistencës direkte me përfitueset, ***D&E ka punuar e mbështetur dhe familjen e viktimës-*** p.sh fëmijët e përfitueses, asistencë për familjet e përfitueseve (prindërit, motrat apo vëllezërit) në mundësinë e gjetjes së një pune, shoqërimi dhe rregjistrimi tek Zyrat e Punës, ndihmë me paketë ushqimore, përfshirja në programe apo shërbime të ofruara nga sigurues të tjerë shërbimesh në komunitet, rregjistrimi në kurse profesionale, këshillim familjar, etj.

Shërbime psikologjike e sociale
Vlerësimi i nevojave psiko-sociale nga psikologia e D&E është kryer për çdo rast të ri të hyrë në program gjatë vitit 2015. Për të gjitha rastet e asistuara gjatë këtij viti në programin e riintegrimit është ofruar këshillim bazuar në nevojat e secilit rast.

Duke iu referuar shërbimit psiko-social janë realizuar:
- ***Këshillim individual*** psikologjik dhe psiko-social në RC dhe në Qendrën e Edukimit;
- ***Këshillimi në Grup;***
- ***Terapi arti;***
- ***Terapia okupacionale***.

"Kam qënë shumë keq në fillim kur erdha. Shihja ëndrra të frikshme, qaja dhe mërzitesha kot. Edhe bërtisja gjatë gjithë kohës. " – O . (15 vjeç, e abuzuar seksualisht në moshën 11 vjeç dhe trafikuar kur ishte 14)

"Qaj vazhdimisht, kam vetëm mendime të këqija. Dhe kur mendoj që kam pasur një jetë gjithë vuajtje nuk mendoj se do kem ditë të bukura.. Mendoj ndonjëherë t'i jap fund jetës se nuk kam më fuqi"- U. (21 vjeç, e braktisur nga prindërit që në fëmijëri dhe e trafikuar kur ishte minorene)

"Jam shumë e acaruar gjatë gjithë kohës me të gjithë, bëhem shumë nervoze, jam e lodhur se edhe nuk bëj gjumë të mirë" - T. (14 vjeç, e abuzuar seksualisht dhe e trafikuar)

Janë realizuar 1082 seanca të këshillimit individual gjatë të cilave përfituesit janë asistuar në trajtimin e simptomave të ankthit, depresionit, stresit posttraumatik, ankthit social, pagjumësisë, menaxhimin e zemërimit, stresit dhe zgjidhjen e konfliketeve.

Nr	Asistenca Psikologjike	Nr. seancave
1	Seanca individuale keshillimi psikologjik	1082
2	Terapi Arti ne Grup	53
3	Terapi Arti e Loje (perfituesit dytësorë)	7

„ Jam më e qetë tani, jam e lumtur me gjërat që po bëj, e vënë re të gjithë ndryshimin tim" - E. (Viktimë e dhunës sistematike dhe abuzimit seksual pas trajtimit psikologjik për një periudhë 6 mujore)

„ Askush nuk më ka dëgjuar dhe nuk kam folur me njeri për gjërat që më kanë ndodhur. Kur flas këtu ndihem e lehtësuar" - H. (viktimë trafikimi dhe abuzimi)

Terapi Arti në Grup

Ana është abuzuar seksualisht në moshën 11 vjeçare dhe më pas u trafikua duke shpëtuar nga kjo eksperiencë vetëm kur ishte 14 vjeç. Ajo sapo kishte mbushur 15 kur filloi të frekuentonte grupin e terapisë së artit. Ajo ishte e tërhequr, ishte mosbesuese ndaj të tjerëve, kishte vetëvlerësim të ulët, dhe e kishte të vështirë të përfshihej në biseda me të tjerët. E vetmja mënyrë se si mund të përfshihej në aktivitete grupi pa u shqetësuar ishte duke pikturuar. Ajo tregon se sa shumë e pëlqen faktin që është pjesë e grupit dhe njëkohësisht nuk shqetësohet nga prezenca e të tjerëve, sepse ky aktivitet e lejon që ajo të ndjekë ritmin e saj, të shprehë vetën pa pasur nevojë për fjalë, dhe mbi të gjitha e bën të ndihet e vlefshme dhe krijuese. Krahas seancave të këshillimit, Terapia e Artit ishte pjesë e planit të trajtimit të Anës të cilat ndihmuan rikuperimin e saj.

Ashtu is Ana, 25 përfituese të tjera kanë qënë pjesë e kësaj eksperience të sjellë në 53 seanca grupi gjatë 2015. Seancat lehtësohen nga psikologia dhe asistohen edhe nga 2 vullnetare të organizatës.

Disa nga teknikat e përdorura janë:
Ëndrra ime;
Vizato një urë;
Krijo botën tënde;
E ardhmja;
Më e mira e vetes sime;
Dritarja e jetës;
Liria ime;
Burimet;
Rruga e jetës;
Piktura e stresit;
Piktura e zemërimit;
Vizatimi i vëndit të sigurtë;
Ti je një pemë;
Si jam, si më shohin, si dua të jem;
një letër për Santan;
Një urim eti.

Kursi i artit dhe punëve të dorës

„ Më pëlqejnë gjërat që krijoj këtu. Familja ime nuk mund ta besonte që atë kartolinën që u shkrova e kisha krijuar vetë“ - E.

Përfitueset krijuan kartolina për festa dhe evente speciale. Disa nga këto kartolina u shitën në panair, disa të tjera u përdorën nga përfitueset për t‘iu uruar festat të afërmve.

„ Motrës i dhurova për ditëlindje vathët që i punova vetë tek kursi. Është një dhuratë shumë domethënëse, e kam krijuar me dashuri dhe me duart e mia. Dhe unë u ndjeva shumë e lumtur që munda të bëj diçka për të“ - D.

Përfitueset punojnë bizhu të ndryshme, ku një pjesë shiten nëpër panaire dhe një pjesë tjetër mbahet nga ato për përdorim. Në të njëjtën mënyrë ato punojnë me bluzat duke i personalizuar me shkrime duke përdorur bojra të veçanta. Punë të ndryshme artistike janë bërë vazot, telajot, materiale të ricikluesshme duke krijuar zbukurime, mjete për përdorim të përditshëm si kuti bizhush, mbajtëse lapsash etj.

Terapi Arti dhe Loje (përfitues sekondar)
Gjatë periudhës së raportimit, janë asistuar edhe fëmijë të përfitueseve, me seanca këshillimi individuale. Është ndërhyrë përmes Artit dhe Lojës për të trajtuar disa vështirësi që fëmijët shfaqnin. Fëmijët janë referuar nga mamatë për shkak të simptomave të ankthit që shfaqnin. Nga vlerësimi rrezulton që për shkak të ekspozimit ndaj dhunës fëmijët shfaqin ankesa fizike, shqetësime me gjumin, vështirësi në marrëdhënie me moshatarët, rënie të nivelit akademik, shqetësim të vazhdueshëm etj.

Asistencë shëndetësore
Stafi mjekësor i D&E ka adresuar dhe trajtuar nevojat mjekësore të përfitueseve të programit të Qendrës së Riintegrimit. Këto lloje shërbimesh janë ofruar kryesisht për përfitueset që janë të akomoduara në Qendrën e Riintegrimit, por edhe për ato të cilat janë në fazën e dytë të programit. Pas vlerësimit mjekësor të realizuar nga doktoresha, rastet e reja të sapo hyra në program janë mbështetur të bëjnë analizat rutinë (gjak komplet, urina, ekzaminimet SST, etj).

Gjashtë përfituese shtatzanë janë mbështetur me asistencën e duhur mjekësore, ndjekje tek mjeku obstetër-gjenekolog dhe kanë lindur gjatë kësaj periudhe.

Diagnoza mjeksore

Sëmundja	Infeksione urinare	Probleme gastro-intestinale	Probleme dermatologjike	Colic abdominal and renal	ORL problems	Probleme alergjike	Probleme gjinekologjike	Anemia	Probleme dentare	Okulist
Nr. i rasteve	**6**	**7**	**6**	**4**	**17**	**5**	**18**	**8**	**9**	**7**
Nr i fëmijëve		**1**		**1**	**10**	**1**		**2**		

Ekzaminimet mjekësore

Ekzaminimet	STD		HIV/AIDS	
	Ekzaminuar	Positive	Ekzaminuar	Positive
Nr. irasteve	27	12	27	0

Probleme të shëndetit mendor

Çrregullime mendore/Sëmundje	**Përfituese**	**Fëmijë**
PTSD	3	2
Epilepsi		1
Borderline	1	
Çrregullime të Depresionit	2	
Skizofreni	1	

Rastet që kanë rezultuar pozitiv për STD kanë qenë me diagnozat: Candida, Gonorrhea dhe Trichomonas vaginalis. Fatmirësisht asnjë rast me Hepatit apo HIV (+)

Përfundimisht pas një lobimi të vazhdueshëm nga Ministria e Punëve të Brendshme, me Ministrinë e Shëndetësisë dhe ISKSH, është realizuar pajisja me kartat e shëndetit të përfitueseve të asistuar në programin e D&E. Këta përfitues do të kenë mundësinë të marrin shërbim shëndetesor falas pranë mjekes së tyre të familjes në QSH Nr 9, në Tiranë. Ky shërbim do të ofrohet për një periudhe 1- vjeçare, me të drejtë rinovimi.

- D&E ka vazhduar bashkëpunimi me *Albanian University- Dega Stomatologji*, nëpërmjet të cilit janë siguruar shërbime dentare falas për përfitueset e programit dhe gjithashtu me *"Qendrën Komunitare të Shëndetit Mendor nr.1 dhe 2"dhe ISHP.*

- Stafi mjekësor ka organizuar diskutime në grup mbi çështjet e shëndetit si: infeksionet seksualisht të transmetueshme, ushqyerja e femijës 0-12 muajsh, higjena personale, mbrojtja nga temperaturat e ulëta, etj.

Asistencë ligjore

Gjatë kësaj periudhe D&E ka ofruar mbështetje dhe këshillim ligjor për përfituesit e saj. Ndihma ligjore është ofruar për çdo përfitues në varësi të nevojave dhe specifikave të rastit. Për raste të veçanta, për të cilat kërkohet një ekspertizë më profesionale, D&E ka

bashkëpunuar me organizata të tjera me ekspertizë në fushën e përfaqësimit dhe ndihmës juridike si: Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare (QNLQ) dhe TLAS.

- Vlerësimet ligjore

Vlerësimi i nevojave ligjore i paraprin të gjithë procesit të ndihmës juridike të realizuar gjatë trajtimit të rastit në qendër dhe jashtë saj. Juristi i qendrës së D&E është personi përgjegjës për vlerësimin e nevojave ligjore të përfituesit të referuar në qendër. Vlerësimi kryhet në ditët e para të përfshirjes në programin e ndihmës nëpërmjet një interviste të drejtëpërdrejtë të rastit në prezencën edhe të menaxherit të rastit.

- Rastet e asistuara në gjykatë

27 përfituese të programit të D&E të cilat kanë patur procese gjyqësore kundër trafikanteve të tyre janë informuar vazhdimisht rreth çështjeve të tyre përmes takimeve direkte me prokurorët e çështjeve. Shumica e çështjeve janë ndjekur pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

- Zhvillimi i temave ligjore

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015 janë zhvilluar rregullisht ***takime në grup*** me përfituesit për të trajtuar tema të ndryshme ligjore. Këto seanca kanë shërbyer për të informuar dhe këshilluar përfitueset për tema dhe situata të ndryshme ligjore. Temat e përzgjedhura janë të lidhura me probleme që shqetësojnë në praktikë përfitueset, por edhe informuese dhe edukative për kuadrin ligjor dhe procedura të ndryshme. Në këto takime perfitueset kanë patur mundësinë te bëjnë pyetje dhe të sqarojnë shumë situata apo paqartësi lidhur me legjislacionin apo procedura të ndryshme. Sipas një grafiku të paracaktuar për periudhën Janar – Dhjetor 2015 janë zhvilluar gjithsej 17 seanca me tema ligjore:

1. **Të drejtat e njeriut duke u fokusuar tek të drejtat themelore të njeriut të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe ligje të tjera;**
2. **Kuadri ligjor që rregullon fushën e luftës kundër trafikimit, në veçanti dispozitat e Kodit Penal që dënojnë trafikimin e personave;**
3. **Kuadri ligjor qe rregullon mbrojtjen nga dhuna ne familje – Urdhri i mbrojtjes dhe te drejtat e personave te dëmtuar nga dhuna ne familje;**
4. **Të drejtat e fëmijëve parë në kontekstin e ligjit të 2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve - Kujdesi për fëmijet e përfitueseve ne shellter:**
5. **Kuadri ligjor që rregullon fushën e regjistrimit në gjendjen civile (regjistrimi i lindjeve, transferimi i dokumentacionit, elemente që kanë të bëjnë me të dhëna të tjera të regjistrit të gjëndjes civile);**
6. **Tema të lira për familjen dhe të drejtën familjare (familja si koncept ligjor, Martesa, zgjidhja e martesës, pjesëtimi i pasurisë pas martesës, caktimi i kujdestarisë, detyrimi ushqimor, birësimi etj);**
7. **Sistemi i drejtesisë në Shqipëri – Njohja me sistemin gjyqësor dhe shkallët e gjykimit tëçështjeve penale dhe civile, aksesi në drejtësi;**
8. **Njohja me Insitucionet Publike (Pushteti Qendror dhe Pushteti Vendor);**
9. **E dretja e jetës – (respektimi i jetës së tjetrit, vetëgjyqësia dhe besimi tek drejtësia);**
10. **E drejta e informimit për dokumentet zyrtare - Avokati i Popullit;**
11. **Ndihma ekonomike dhe proçedurat e aplikimit për ta përfituar atë;**
12. **E drejta e jetës private – ruajtja e konfidencialitetit dhe respektimi i privatësisë së tjetrit;**
13. **E drejta e pronës private, pozita e femrave në raport me pronën;**

D&E ka asistuar dy raste me shtetësi të huaj, një me shtetësi angleze dhe një me shtetësi kongoleze. Përfitueset janë asistuar për praktika dhe procedura që kanë të bëjnë me sigurimin e dokumentacionit apo për aplikime të ndryshme, për shërbime apo veprime nëpër institucione. Për përfituesen me shtetësi angleze është marrë informacion nga Njësia Vendore ku ka qenë e regjistruar si dhe është mundësuar regjistrimi i fëmijës së porsalindur. Për këtë përfituese është siguruar gjithashtu leja e qëndrimit dhe më pas edhe e punësimit, gjithashtu rasti është asistuar për të kryer procedurat përmbarimore për ekzkekutimin e vendimit gjyqësor me objekt takimin e fëmijëve. Gjatë muajit shtator për këtë përfituese janë përgatitur dokumentet për pajisjen e fëmijës së saj me pasaportë angleze. Për përfituesen me shtetësi kongoloze është duke u bashkëpunuar me strukturat përkatëse për pajisjen e saj me leje qendrimi dhe rregjistrimin e fëmijës së saj në Gjendjen Civile.

6 përfituese të D&E kanë aplikuar për ID card. D&E ka bashkëpunuar gjithashtu me Njësinë Bashkiake të zonës ku ndodhet strehëza për rregjistrimin e rasteve në gjendjen Civile. Për pajisjen e përfitueseve me çertifikata lindjeje dhe familjare është bashkëpunuar me Drejtorinë e Policisë të zonave nga ku rastet vijnë.

Trainime për punësim, kurse profesionale

Në total ***31 përfitues kanë ndjekur kurse profesionale***. Disa përfitues kanë ndjekur më shumë se një kurs, bazuar në aftësitë dhe dëshirat individuale.

Kurse profesionale / Trainime profesionale

Nr	Kurse	Ofruar	Nr. I rasteve
1.	Italisht	Qendër e Gjuhëve tëHuaja Vullnetare D&E	**1** **8**
2.	Sekretari	Qendra e formimit profesional	**1**
3.	Parukeri & Estetikë	Qendra e formimit profesional Sallon Privat	**6**
4.	Kuzhinë	Qendra e formimit profesional Qendër Private e formimit profesional	**4**
5.	Rrobaqepsi /Stilim	Atelie private	**1**
8.	Kurs kompjuteri	Qendra e Edukimit D&E	**22**
9.	Anglisht	Vullnetare D&E Qendër e Formimit Profesional Qendër private	**10** **3** **2**
10.	Kurs kitare	Qendra e Edukimit D&E	**20**
12.	Kurs gjermanisht	Qendra e Kurseve Univers	**1**
13.	Kurs Stilimi	Sallon Atelie privat	**1**
14.	Kurs fotografie	Fotograf privat	**1**

Klasat e prindërimit- gjatë periudhës se raportimit janë zhvilluar klasat e prindërimit për nënat e reja dhe gratë shtatzana per t'i ndihmuar ato në procesin e prindërimit, pra me qëllim

rritjen e aftesive prindërore dhe rritjen e fëmijëve të shëndetshëm. Në këtë aktivitet disaditor morën pjesë 5 raste.

Edhe gjatë kësaj periudhe trainimet dhe aktivitetet edukuese për përfitueset e D&E në Qendrën e Edukimit kanë qenë thelbësore. Për të rritur aftësitë për jetën për përfitueset, stafi i D&E ka organizuar aktivitete të ndryshme, trainime për çështje të ndryshme, diskutime në grup, lexim të librave artistik, mësim të materialeve shkollore si dhe i materialeve të kurseve ku ato marrin pjesë.

Edukim dhe shkollim

Për rastet e reja të hyra në program është bërë nga mësuesja e D&E një vlerësim për përcaktimin e nivelit arsimor të çdo përfitueseje dhe më pas është zhvilluar një plan edukativo-mësimor si pjesë e planit të riintegrimit të çdo përfitueseje.

- ***30 përfituese kanë ndjekur gjatë kësaj periudhe shkollën***, 3 prej të cilëve kanë ndjekur Universitetin.
- Përfitueset janë ndihmuar rregullisht nga mësuesja e D&E për t'u përgatitur, veçanërisht për lëndët ku ato kanë pasur boshllëqe nga e kaluara.
- Të gjitha përfitueseve iu janë siguruar librat si edhe mjetet e tjera shkollore të nevojshme për një vijueshmëri sa më të mirë akademike.
- Për raste të tjera të akomoduara në Qendrën e Riintegrimit të cilat nuk kanë ndjekur asnjë klasë shkollë ose shumë pak është punuar personalisht me secilën prej tyre kryesisht në shkrim, lexim, matematikë, etj.
- Sesione informuese të ndryshme janë organizuar nga mësuesja e D&E lidhur me çështje të ndryshme.
- Për rregjistrimin e rasteve specifike në sistemin shkollor D&E ka bashkëpunuar me Autoritetin Përgjegjës, Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve dhe Drejtorine Arsimore Rajonale të Tiranës.

- Tema të diskutuara:

Sesione informuese të ndryshme janë organizuar nga mësuesja e D&E lidhur me çështje të ndryshme si më poshtë:

- BE dhe shtetet anëtare
- Tërmetet
- Stinët dhe ekuinoksi
- Veshjet e përshtatshme për raste të ndryshme
- Si të bëjmë një lajmërim, një kronikë, si të bëjmë një ankesë, një kërkesë, një ftesë

a) *Tema mësimore:*
- Si ta kuptojmë përmbajtjen e një shkrimi, si ta themi në vetën e tretë;
- Mbledhje, zbritje me numra dy-tre shifrorë;
- Si bëhet projekti i një apartamenti;.

b) *Tema zbavitëse*:
- Gjëegjëza problemore,
- ushtrime sugjestionuese,

- imitime të aktorëve të humorit,
- puzzel etj.

c) *Njgjarje historike:*
- 17 Janari – Vdekja e Skënderbeut
- 17 Shkurti- Pavarësia e Kosovës
- Kongresi i Lushnjës
- 7 Marsi- Dita e Mësuesit
- 8 Marsi – Dita Ndërkombëtare e Grave
- 1 Maji – Dita e Punëtorëve
- 5 Maji – Dita e Dëshmorëve
- 1 Qershori- Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve
- 18 – Tetori - Lumturimi i Nënë Terezës
- 28- Nëntori – 102 vjetori i Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë
- 29- Nëtori - 70- Vjetori i Çlirimit të Atdheut

d) *Aktivitete argëtuese, relaksuese të organizuara*

- 14-Shkurti (San Valentini)
- 7-8 Marsi
- 102 vjetori i Pavarësisë
- 70-vjetori i Çlirimit të Shqipërisë
- Festime të ditëlindjeve të përfitueseve dhe të fëmijëve
- Biseda të lira në lidhje me jetën në shelter
- Komunikimi i bukur - çelësi i suksesit

Ndërmjetësim me familjen

Menaxherët e rasteve kanë organizuar seanca këshillimi jo vetëm për rastet e akomoduara në qendër por gjithashtu për prindërit e tyre, motrat e vëllezërit.

- 31 përfituese janë asistuar në familjet e origjinës.
- 10 raste të hyra në program gjatë kësaj periudhe janë asistuar direkt në familje.
- 4 përfituese janë bashkuar me familjet e tyre gjatë kësaj periudhe dhe vazhdojnë të ndihmohen nga D&E.
- Rastet e akomoduara në RC janë mbështetur nga stafi D&E në stabilizimin e marrëdhënieve më familjet e tyre.
- Rastet shoqërohen në takime me familjarët nga punonjëset sociale dhe psikologia në Tiranë, gjithashtu ratet janë shoqëruar për t'u takuar me të afërmit në qytetet apo fshatrat ku ata banojnë.

- D&E ka bashkëpunuar me policinë apo organizata të tjera lokale për vendosjet e kontakteve me familjen si dhe në organizimin e takimeve pranë ambienteve të Drejtorisë së Policisë veçanërisht për përfitueset të cilat kanë patur probleme sigurie.
- Realizohen vazhdimisht telefonata me familjarët.

Aktivitetet social - kulturore

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar disa aktivitete sociale për përfitueset. Aktivitetet janë organizuar si brenda dhe jashtë qendrës.

- Aktivitetet e organizuara brenda shelterit kane qenë:

- *diskutime grupi* me tema të ndryshme si: dhuna në familje dhe masat mbrojtëse; barazia gjinore dhe përfshirja e femrave në vendimarrje; veshja e duhur për një intervistë pune; arsimi dhe zgjedhja e karrieres; si të pergatisim nje CV punësimi, etj
- *festimi i festave* të ndryshme;
- *festimi i ditëlindjeve* të përfitueseve;
- *workshopet e kuzhinës* nëpërmjet të cilave përfitueset mësojnë të gatuajnë receta të ndryshme; *kinamaja* e organizuar në shelter (DVD të siguruara nga D&E) ku përfitueset kanë parë filma të ndryshëm argëtues;
- *lojra të ndryshme argëtuese, energjike;*
- përgatitja e *punëve të dorës, qëndisje*;
- *mbrëmje muzikore* të organizuara çdo të shtunë;
- *leximi i librave* të ndryshëm nga biblioteka e D&E;
- *lojra energjike;*
- *Fitnes;*
- *Aktivitete okupacionale;*
- *Yoga.*

- Aktivitete jashtë shelterit:

Janë organizuar një sërë aktivitetesh edhe jashtë strehëzës me karakter zbavitës por dhe informues.

Kështu disa aktivitete të organizuara janë:

- vizitë në Malin e Dajtit pranë qytetit të Tiranës;
- koktej në një bar për ditën e San Valentinit dhe Ditën e Gruas;
- piknik në liqenin artificial të Tiranës;
- vajtja në Kishën e Laçit;
- vizitë në amfiteatrin e Durrësit;
- vajtja e nënave me fëmijë në kënde lojrash apo lokale me lojra për fëmijët e tyre;
- vajtja në plazh/ pishina 4 dite në muajin Qershor
- Vizite në kishën në Kepin e Rodonit
- Plazh në Gjirin e Lalzit
- Pishina 2 javë gjatë muajit Gusht
- Piknik tek liqeni artificial

Aktivitete argëtuese jashtë Qendrës

Me rastin e festave të fundvitit Koordinatorja Kombëtare Antitrafik ka shpërndarë dhurata për përfitueset e akomoduara në Qendër.

Asistencë për fëmijët e përfitueseve

Gjatë kësaj periudhe janë asistuar në programin e D&E 81 fëmijë të shoqëruar me nënat e tyre nga ku 5 fëmijë janë ndihmuar në Qendrën e Riintegrimit dhe 76 janë asistuar bashkë me nënat në fazën e dytë të programit.

- 20 fëmijë të përfitueseve kanë shkuar rregullisht në çerdhe dhe në kopësht nga ku ***12 janë fëmijë te VT/VMT;***
- 35 fëmijë kanë ndjekur rregullisht shkollën nga ku ***7 janë fëmijë të VT/VMT***;
- Të gjithë fëmijët kanë bërë vaksinat në bazë të skemës së vaksinimit dhe janë ndjekur rregullisht nga pediatri;

D&E ka bashkëpunuar me Qendrën Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të fëmijëve për rregjistrimin e fëmijëve në kopësht dhe çerdhe.

Ndihmë financiare dhe afatgjatë

- 99 raste dhe 73 fëmijë, gjatë kësaj periudhe, janë asistuar me shërbime në komunitet në fazën e dytë dhe të tretë të Programit të Riintegrimit.
- Nga këto, 63 raste dhe 55 fëmijë janë ndihmuar në apartamente, 31 raste dhe 16 fëmijë janë mbështetur në familjet e tyre, 9 përfituese dhe 2 fëmijë janë asistuar në vende të tjera alternative.
- 23 përfituese të reja dhe 32 fëmijë të tyre kanë hyrë në program duke u ndihmuar direkt në apartament, 10 përfitues dhe 4 fëmijë të tyre kanë hyrë në program duke u ndihmuar direkt në familje; 2 përfitues dhe 1 fëmijë është asistuar direkt në vend tjetër alternativ;
- 7 raste kanë kaluar nga qendra për t'u mbështetur në apartament me qera, 6 raste dhe 1 fëmijë kanë kaluar nga qendra per t'u mbështetur në familjen e origjinës;
- 1 përfituese dhe fëmija i saj kanë kaluar nga qendra per t'u mbështetur në vend tjetër alternativ.
- D&E ka mbështetur përfituesit financiarisht me mbulimin e qerasë së apartamenteve në fazën e dytë të Programit të Riintegrimit, të konsideruar si shumë të rëndësishëm në procesin e fuqizimit të përfituesve, si dhe në drejtim të riintegrimit të suksesshëm në shoqërinë shqiptare.

Informacion mbi shërbimet në komunitet

Menaxherët e rasteve të D&E sigurojnë mbështetje të vazhdueshme për rastet që ndihmohen në fazën e dytë dhe fazën e tretë të riintegrimit, duke ju ofruar informacionin e nevojshëm për shërbimet ekzistente që ofrohen në komunitet.

Harta e shërbimeve në komunitet u është shpërndarë përfitueseve, por gjithashtu ato shoqërohen nga menaxherët e tyre për të njohur vendet dhe adresat e këtyre shërbimeve.

- Përfitueset informohen për të drejtën e përfitimit të asistencës ekonomike si VeT, dhe mbështeten për të plotësuar dokumentat e nevojshme.
- Përfitueset nëna të vetme me fëmijë janë informuar dhe mbështetur për marrjen e statusit të jetimit për fëmijët e tyre në bashkëpunim me DRSHSSH

- Përfitueset të cilat janë në fazën e dytë dhe të tretë të programit janë informuar nga doktori i D&E rreth proçedurave për të përfituar shërbime shëndetësore falas në institucione shëndetësore shtetërore. Gjithashtu ato jane ndihmuar për të përgatitur dokumentacionim përkates shëndetësor në vendet e tyre të origjinës dhe transferimin e këtyre dokumentave tek mjeku i familjes në Tiranë.
- Janë informuar dhe mbështetur familjet e viktimave / viktimave të mundshme të trafikimit lidhur me mundësinë e përfitimit të ndihmës ekonomike në bashkepunim po me DRSHSSH.
- Përfitueset janë informuar dhe mbështetur për kryerjen e procedurave dhe plotësimin e dokumentave lidhur me rregjistrimin e fëmijëve në çerdhe, kopësht dhe shkolla si dhe përgatitja e dokumentave për përfitimin e çerdhes dhe kopshtit falas për rastet nëna të vetme me fëmijë.

Monitorimi dhe ndjekja e rasteve

Përfitueset e fazës së dytë dhe të tretë të programit të D&E janë mbështetur me të gjitha shërbimet në komunitet të përmendura më lart bazuar në nevojat e tyre.
Monitorimi i përfituesve vazhdon të kryhet me anë të takimeve direkte, ashtu edhe me anë të kontakteve të rregullta me telefon.
Sesione të rregullta këshillimi janë ofruar nga psikologia e D&E për përfituesit në program, të cilët janë aktualisht në fazën e dytë të riintegrimit. Kontakte të rregullta përfituesit e fazës së dytë të programit të riintegrimit kanë edhe me menaxherët e rasteve. Gjatë kësaj periudhe stafi ka monitoruar dhe ka bërë takime direkte me përfitueset të cilat jetojnë në qytetet e tyre të origjinës si Durrës, Berat, Kuçovë, Fier, Vlorë, Elbasan, Korçë, Pogradec, Lezhë dhe Shkodër.

b. KONTRIBUTI NË KTHIMIN E ASISTUAR TË VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT APO VMT

D&E ka ndihmuar në kthimin vullnetar të asistuar të dy rasteve viktima të mundshme të trafikimit.

D&E ka bashkëpunuar me organizatën "SOLWODI" në Gjermani, për kthimin, mbështetjen dhe ofrimin e asistencës në vendin e origjinës për dy raste që me informacionin e dërguar nga organizata rezultonin të shfrytëzuara. Një rast është asistuar në familje bashkë me fëmijën e saj dhe rasti tjetër është asistuar në apartament me qera bashkë me fëmijën e saj duke marrë të gjithë ndihmën për të cilën kanë patur nevoje në bashkëpunim dhe me organizatën SOLWOLDI në Gjermani. Të dyja rastet vazhdojnë të jenë në Programin e Riintegrimit të organizatës.

D&E ka vazhduar gjithashtu bashkëpunimin me organizatën në Spanjë "**SICAR cat Serveis"** ku vazhdon të asistohet një vajzë shqiptare, viktimë trafikimi e shfrytëzuar për qëllime seksuale e cila ka kërkuar vazhdimisht të lidhej me fëmijët e saj që jetonin në Tiranë për të cilët ajo mendonte se shfrytëzoheshin për lypje. D&E ka ndërmjetësuar me ARSIS që fëmijët të frekuentonin qendrën ditore, për mundësinë e pajisjes me libra shkollorë si dhe me mundësinë e punësimit të personave që kujdeseshin për fëmijët.
Për kthimin dhe asistimin e rasteve është bashkepunuar dhe vënë në dijeni dhe Autoriteti Përgjegjës duke u informuar për rastet në fjalë.

c. ASISTENCË DIREKTE PËR MESHKUJ VIKTIMA TË TRAFIKIMIT

Gjatë kësaj periudhe D&E ka ndihmuar 24 meshkuj viktima/viktima të mundshme trafikimi nga të cilët 6 meshkuj viktima/viktima të mundshme të trafikimit dhe 1 rast viktimë e abuzimit seksual janë raste te reja të referuara pranë programit riintegrues të D&E. Në bashkëpunim me menaxherët e rasteve të D&E, është ndërtuar një plan riintegrimi për secilin rast dhe janë mbështetur për të arritur objektivat e vendosur në plan.
Rastet meshkuj VT e VMT janë mbështetur me këshillim psiko-social, ndihmë ligjore, asistencë mjekësore, mbështetje për të gjetur një punë, mbështetja financiare për pagesën e apartamentit me qira; trainimi për të rritur aftësitë per jetën; ofrimi i informacionit dhe ndërmjetësimi për marrjen e shërbimeve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të ndryshme në komunitet, monitorimit dhe ndjekja, etj. Psikologu i D&E ka ofruar seanca të rregullta këshillimi individual për të gjithë përfituesit meshkuj në program.
Gjatë vitit 2015, 6 raste meshkuj viktima trafikimi dhe 1 rast viktimë e abuzimit seksual janë ndihmuar me subvencionimin e pagesës së qerasë për një periudhë të caktuar në varësi të nevojave të rastit. Nga të gjitha rastet meshkuj të futur në program që nga viti 2012, 17 raste kanë pasur nevojën më bazike pikërisht strehimin. Kjo tregon që strehimi mbetet një ndër nevojat më bazike të meshkujve viktima trafikimi apo viktima të mundshme trafikimi të asistuar deri tani. Mungesa e mëparshme e strehimit apo gjendja në situatë rruge në një moment të caktuar është një ndër faktorët kryesorë që meshkujt e rinj të moshës 15-22 vjeç të bien pre e shfrytëzimeve të llojeve të ndryshme.

Gjatë vitit 2015 janë ndihmuar me ndërmjetësim për punësim apo fuqizim ekonomik disa raste. Në ndihmë të këtij procesi, në lidhje me të ardhmen profesionale, ka qenë edhe "Cikli i Këshillimit drejt Punësimit", i cili ofron trainim mbi komponentët e rëndësishëm të procesit të punësimit. Gjatë këtij viti një përfitues ka mbaruar me sukses "Ciklin e Këshillimit drejt Punësmit". Një përfitues tjetër është fuqizuar ekonomikisht nëpërmjet blerjes së materialeve për tregëti. Një tjetër përfitues është mbështetur për të filluar një stazh pune tek një restorant në Tiranë. Një prej përfituesve po pret të fillojë punë në një fast-food. Një përfitues tjetër i ndihmuar nga organizata me blerjen e një motociklete që në vitin 2014, vazhdon të punojë si i vetëpunësuar dhe ka pasur të ardhura të qëndrueshme. Dy prej përfituesve vazhdojnë të jenë të punësuar si kamarier tashmë prej një kohe të qëndrueshme.
Nga të gjitha rastet e asistuara gjatë këtij viti (të cilët janë ende në programin e ndihmës apo janë në fazë monitorimi), 6 prej tyre aktualisht punojnë në punë të qëndrueshme ose janë të vetëpunësuar, 1 është ndihmuar me një grant të vogël për fuqizim ekonomik, 4 vazhdojnë shkollimin, 1 përfitues vazhdon të marrë kemp për shkak të paaftësisë në punë ndërsa pjesa tjetër janë në kërkim të një pune, punojnë në punë të paqëndrueshme, ose janë në proces formimi profesional.

Një ndër sfidat kryesore që mbetet lidhur me punësimin e meshkujve viktimave të trafikimit/ viktimave të mundshme të trafikimit është fakti që shumica e përfituesveve kanë nivele të ulta edukimi dhe përvojë shumë të pakët pune. Kjo e bën procesin e riintegrimit dhe të qëndrueshmërisë në punë të vështirë për disa përfitues. Shpesh, ata duhet të provojnë 2-3 punë të ndryshme derisa të gjejnë veten në një punë të caktuar. Gjithashtu tregu aktual i punës është relativisht i varfër për këtë grupmoshë dhe i vetmi profil pune që gjen masivisht në njoftimet e punësimit, është puna si banakier apo kamarier.

Duke marrë shkas nga eksperienca e viteve të kaluara, është parë që një ndër nevojat e rëndësishme për përfituesit e asistuar, sidomos ata të grupmoshës 16-18 vjeç, është përmbushja e nevojave të tyre sociale. Të tilla aktivitete rrisin vetvlerësimin e tyre, rrisin aftësitë sociale dhe shërbejnë si një shpenzim kohe i shëndetshëm, përkundrejt aktiviteteve të dëmshme që kanë mësuar gjatë kohës që kanë qënë ne situatë rruge si luajtja e pakontrolluar e lojërave të fatit, konsumimi i duhanit apo i drogave të tjera, frekuentimi i rretheve shoqërore të dëmshme etj. Nisur nga kjo nevojë, djemtë e kësaj grup-moshe janë ndihmuar të marrin pjesë nëpër aktivitete të ndryshme festive të lidhura me shkollën e tyre apo me ambientin e tyre social.

Një ndër pjesët më sfiduese të punës me meshkujt viktima të trafikimit, por njëkohësisht edhe më të rëndësishme për të ndryshuar situatën e rasteve, është puna me familjet e tyre repektive. Pavarësisht se fokusi kryesor i punës është përfituesi vetë, puna me familjet bëhet shumë e rëndësishme sidomos kur përfituesi është i mitur, apo edhe kur si rrjedhojë e punës me familjen mund të ndryshojë edhe gjendja e rastit. Në këtë kuadër, 9 prej familjarëve të meshkujve viktima të trafikimit janë ndërmjetësuar për punë ose janë ndihmuar që të rregjistrohen tek Zyrat e Punës. 3 prej tyre janë ndihmuar me nevoja bazike (veshmbathje dhe ushqim) për shkak të varfërisë ekstreme ku ndodheshin familjet. Një prej tyre është ndihmuar dhe informuar që të aplikojë për ndihmë ekonomike.

d. RRITJA E PËRPJEKJEVE PËR IDENTIFIKIMIN E VeT

Gjatë vitit 2015, në kuadër të punës për identifikimin e viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit, D&E është angazhuar si pjesë e skuadrave të terrenit që po zbatojnë nismën për fëmijët në situatë rruge e iniciuar nga Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Shërbimi Social Shtetërorë. Qëllimi i kësaj nisme është identifikimi i fëmijëve në situatë rruge dhe marrja e hapave të mëtejshëm për menaxhimin e rastit. Janë ngritur 11 skuadra terreni që korrespondojnë me zonat administrative të qytetit të Tiranës, të përbëra nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe një punonjës nga organizatat që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. D&E gjatë muajit janar ka ndihmuar skuadrat e terrenit me dalje periodike gjatë mbasditeve (3 herë në javë) dhe fundjavave. Nga muaji Mars, D&E ka ndihmuar "Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve" nr.3 me daljet e përjavshme në terren. Daljet në terren janë kryer një herë ose dy herë në javë bazuar në kalendarin e përgatitur nga Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve. Gjatë këtyre daljeve në terren janë identifikuar 14 raste të fëmijëve në situatë rruge të cilët janë gjendur duke ushtruar aktivitetin e lypjes, duke shitur apo duke u marrë me riciklim materialesh. Fëmijët janë referuar tek Njësitë përkatëse për Mbrojtjen e Fëmijëve me qëllim marrjen e shërbimeve të ndryshme. 4 prej këtyre rasteve janë menaxhuar nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve nr. 3, ndërsa rastet e tjera janë referuar në Njësitë e tjera të Mbrojtjes së Fëmijëve.

Sfida kryesore e punës në terren me fëmijët në situatë rruge është mungesa e një sistemi referimi që mundëson nxjerrjen e fëmijës nga ajo situatë. Nevojat e këtij target grupi janë shumë të mëdha, duke nisur nga nevojat më bazike siç është ushqimi apo strehimi. Zakonisht janë pjesë e familjeve që kanë qënë nën këtë cikël varfërie për shumë breza dhe thuajse të gjithë prindërit ushtrojnë vetë aktivitetin e lypjes. Ndërkohë shërbimet e ofruara janë jo të mjaftueshme për të siguruar fuqizim të familjes. Gjithashtu, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve

nuk kanë asnjë lloj buxheti për të kryer menaxhim rasti dhe e gjithë puna e tyre menaxhuese mbështetet tek bashkëpunimi me aktorë të tjerë (kryesisht organizata të shoqërisë civile).
Është parë që në një pjesë të mirë të rasteve, fëmijët janë rikthyer përsëri në situatë rruge, sidomos kur ata jetojnë në familje shumë të varfëra sic janë familjet e komunitetit të Bregut të Lumit dhe Shkozës.

"Të Ndryshëm dhe të Barabartë" kanë marrë pjesë gjithashtu në disa tryeza teknike të thirrura nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve të Tiranës. Kështu, gjatë kësaj periudhe stafi i D&E ka marrë pjesë në 5 tavolina multidisiplinare të organizuara nga Njësitë Bashkiake nr. 3, 5, 8, 9 dhe 11.

- **D&E ka realizuar dy sesione informuese për çështjet e shfrytëzimit dhe të trafikimit** me grupin e të rinjve të organizatës SHKEJ të ardhur nga komunitetet e Rr. Jordan Misja dhe Zonës së Treshit në Laprakë. Të rinjtë vinin kryesisht nga familje të varfëra dhe shtresa vulnerable.

e. RRITJA E PËRPJEKJEVE PËR FUQIZIMIN EKONOMIK TË VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

Këshillim dhe mbështetje për punësimin e përfitueseve

Gjatë ketij viti 42 përfituese kanë qenë në marrëdhënie pune si: rrobaqepëse, kuzhiniere, ndihmës kuzhiniere, pjatalarëse në restorant, pastruese, ndihmëse parukiere në sallon parukerie, operatore në call center, banakiere, shperndarës ushqimesh, pasticiere, kamarier, punonjës mobilerie, punonjëse marketi, shitëse peshku, etj.
Stafi i D&E vazhdon të orientojë përfituesit të zgjedhin profesione të kërkuara në tregun e punës, duke u përshtatur natyrisht në çdo rast me aftësitë e tyre personale.

10 përfitues të programit të riintegrimit të D&E kanë qenë të përfshirë në ciklin Këshillues "Këshillim për punësim". Qëllimi i këtij cikli këshillues është t'i ndihmojë ata për të rritur aftësitë në gjetjen dhe mbajtjen e një pune. Përmes këtij programi, përfituesit janë mbështetur për të ndjekur kurse profesionale, trainime në vende pune, për të qenë pjesë e programeve të stazhit pranë kompanive të ndryshme private dhe mundësi për të hapur mikro-biznese.
Lehtësuesi/Trajneri i ciklit këshillues ka punuar me grupet përkatëse për të krijuar ekipe të konsoliduara, për të identifikuar pikat e forta personale të secilit përfitues, duke synuar në afat të gjatë për të rritur aftësitë e tyre në gjetjen dhe mbajtjen e një pune; iniciativat inkurajuese dhe aftësitë hulumtuese të pjesëmarrësve; zhvillimi i kompetencave sociale të grupit; marrja e njohurive dhe përgatitje për stazhe afatshkurtra. Pjesëmarrësit në trainim janë njohur me profesione dhe biznese të reja, duke u përgatitur për një përfshirje të mundshme në praktika pranë këtyre bizneseve. Gjatë takimeve në grup, pjesëmarrësit patën mundësinë për të shkëmbyer përvojën me njeri-tjetrin, ndërkohë që janë zhvilluar dhe Planet Individuale të Zhvillimit.

D&E vazhdon të ketë kontakte të rregullta me Zyrën Rajonale të Punësimit dhe të gjithë përfituesit që janë tashmë gati për të punuar, janë regjistruar pranë këtij institucioni si punëkërkues.

Mbështetja e përfitueseve për hapjen e bizneseve të vogla

Gjatë kësaj periudhe ***5 përfitues të D&E kanë menaxhuar bizneset e tyre***. Përfituesit janë monitoruar rregullisht dhe është siguruar mbështetje teknike sipas nevojave të tyre .

Pilotimi i programit të internship me kompanitë e biznesit

Gjatë kësaj periudhe ***10 përfitues janë të përfshirë në programet e internshipit***: Tre përfitues janë të përfshirë në biznesin social ku dy raste janë të përfshirë si asistent kuzhinier dhe një tjetër si distributor ushqimesh. Përveç kësaj, tre përfitues janë të përfshirë si asistent kuzhinier pranë tre restoranteve të ndryshme; një përfituese si asistente zyre pranë një Shoqate të Krishterë, një rast i përfshirë në një sipermarrje punimesh gipsi; një tjetër si asistente parukiere dhe nje rast i perfshire në një punë në bujqësi.

Intersnhip	Biznesi	Nr i rasteve
Asistent kuzhinier	New York Tirana Bagels (social business)	2
Distributor ushqimesh	New York Tirana Bagels (social business)	1
Asistent kuzhinier	Restorant	1
Asistent kuzhinier	Restorant	1
Asistent kuzhinier	Restorant	1
Asistente zyre	Shoqatë e Krishterë	1
Asistent për punime gipsi	Sipermarrje punimesh gipsi	1
Asistent parukiere	Sallon bukurie	1
Punë në bujqësi		1

f. AVANCIMI I BASHKËPUNIMIT ME OFRUESIT E SHËRBIMIT DHE ME INSTITUCIONET SHTETËRORE LOKALE

Në mënyrë që të sigurojë një paketë të plotë shërbimesh riintegruese, D&E vazhdon të bashkëpunojë me aktorë të ndryshëm shtetërorë dhe jo shtetërorë dhe ofrues të tjerë të shërbimeve në komunitet.

- *Bashkëpunime me institucione shtetërore (lokale dhe qendrore)*
  - ✓ Në bashkëpunim me **Ministrinë e Punëve të Brendshme (ZKKAT), Ministrinë e Shëndetësisë** dhe **ISKSH**, është realizuar pajisja me kartat e shëndetit të përfitueseve të asistuar në programin e D&E. Këta përfitues do të kenë mundësinë të marrin shërbim shëndetesor falas pranë mjekes së tyre te familjes ne QSH Nr 9, në Tiranë. Ky shërbim do te ofrohet për një periudhë 1- vjecare, me të drejtë rinovimi. Aktualisht 16 përfituese janë pajisur me kartë shëndeti dhe 69 përfitues të tjerë janë në proçes;
  - ✓ Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë përmes Njësisë Bashkiake nr.7 dhe më pas Bashkisë Qendrore siguroi edhe këtë vit mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve për ushqim për VT, VMT dhe fëmijët e tyre të akomoduar në Qendrën Riintegruese D&E;

- ✓ **Ministria e Arsimit dhe Drejtoria Rajonale e Arsimit Tiranë** për krijimin e lehtësirave për rregjistrimin e përfitueseve të programit të D&E në sistemin shkollor part time duke marrë në konsideratë çështjet e tyre të sigurisë;
- ✓ **Qendra e Formimit Profesional** për ofrimin e trainimeve e kurseve të ndryshme profesionale për VT e VMT;
- ✓ **Zyrat Rajonale të Punësimit**;
- ✓ **Zyrat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror** në Tiranë, Durrës, Lezhë, Berat përveç se si burim referimi dhe monitorimi të rasteve VT e VMT edhe për krijimin e lehtësirave për to.

- *Bashkëpunime me institucione jo shtetërore, OJF, institucione fetare*

D&E ka bashkëpunuar me **SHKBSH** dhe **Krahët e Shqiponjës** për identifikimin e vendeve të përshtatshme alternative për minorenët, viktima të trafikimit të cilat kanë humbur përkujdesjen e prindërve; **ARSIS**; **CARITAS Albania**; qendra ligjore **TLAS** dhe **QNLQ** per ofrimin e shërbimit ligjor falas për viktimat e trafikimit apo persona të tjerë në nevojë; qendra **"Të Drejtat e Njeriut në Demokraci"; "Qendra për Popullsi dhe Zhvillim**" e cila ka ofruar shërbime shëndetesore per grupin e viktimave të trafikimit.

Në kuadër të punës identifikuese dhe menaxhimit të rasteve një proces mjaft i rëndësishëm është edhe konsolidimi dhe zgjerimi i bashkëpunëtorëve të ndryshëm. Përveç bashkëpunëtorëve të konsoliduar sic është për shembull organizata **ARSISS,** gjatë këtij viti "Të Ndryshëm & të Barabartë" ka bashkëpunuar edhe me aktorë të tjerë me fokus identifikimin dhe menaxhimin e rasteve. Gjatë kësaj periudhe aktorë të tjerë janë përfshirë në identifikim si për shembull **Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve** (konkretisht Njësia 11 për Mbrojtjen e Fëmijëve), apo institucionet rezidenciale për fëmijë (konkretisht **Shtëpia e Fëmijës Parashkollor dhe Shkollor, Sarandë**).

Po kështu **Njësia 11 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Njësia 1 për Mbrojtjen e Fëmijëve** janë përfshirë edhe në bashkë-menaxhim dhe monitorim rastesh.

Gjatë vitit 2015 kemi bashkëpunuar me organizatën **"Meridia"**, e cila ka në fokusin e saj të miturit në konflikt me ligjin, për ofrimin e një periudhe trainimi në punë për një nga përfituesit tanë.

Gjithashtu, po bashkëpnojmë me organizatën **'Terre des Hommes"** për mbeshtetjen me fuqizim ekonomik për dy nga përfituesit e programit tonë.

D&E së bashku me KKSAT organizoi me 9 Qershor 2015 Konferencën **"Ri/integrimin i Personave të Trafikuar në Shqipëri"**, pas përfundimit të projektit të financuar nga KBF. Qëllimi i kësaj konference ishte diskutimi i përfshirjes afatgjatë socio-ekonomike të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore me anë të prezantimit të arritjeve kryesore të **"Programit të Riintegrimit të Viktimave të Trafikimit në Shqipëri".**

g. AKTIVITETE NDËRGJEGJËSUESE PËR TRAFIKIMIN

Gjatë kësaj periudhe D&E ka organizuar një sërë aktivitetesh për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë në lidhje me parandalimin e trafikimit në persona.

Një numër i konsiderueshëm aktivitetesh janë realizuar në kuadër të projektit:

- **"Edukimi i komunitetit për çështje të trafikimit në persona" financuar Programi i Granteve të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së ShBA-së, Tiranë**.

Në kuadër të këtij projekti D&E në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe Korpusin e Paqes organizuan me 11-12 Shkurt 2015 Trainimin e Trajnerëve (ToT) me pjesëmarrjen e 48 profesionistëve lokalë nga zona të ndryshme të Shqipërisë. Objektivi i këtij ToT dy ditor ishte trainimi i profesionistëve për ndërgjegjësimin e komunitetit lidhur me fenomenin e trafikimit, format e trafikimit, shkaqet dhe pasojat e trafikimit, faktorët e rrezikut dhe sistemet e ndërtuara me qëllim ofrimin e mbrojtjes dhe të shërbimeve për viktimat e trafikimit, prezantimi i Strategjisë së Luftës Kundër Trafikimit të Personave dhe Planit të Veprimit, ku një hapësirë e veçantë iu kushtua fushës së parandalimit, si udhërrëfyes për identifikimin dhe referimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

Pas ToT secili pjesëmarrës hartoi një plan për organizimin e të paktën një aktiviteti edukativ në komunitetin ku jetojnë ose punojnë me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi fenomenin e trafikimit në persona.

Në kuadër të këtij projekti u përgatit dhe botua **"Udhëzuesi – Të mbajmë fëmijët të sigurt nga trafikimi": Një udhëzues për profesionistë që punojnë me të rinjtë dhe këshilluesit bashkëmoshatarë në Shqipëri."** Ky udhëzues u hartua me qëllimin për të pajisur të rinjtë me informacione dhe aftësi për të cilat ata kanë nevojë që jenë të sigurt dhe anëtarë aktiv të komunitetit të tyre. **Ndër aktvitetet kryesore edukative të organizuara nga grupi i trainerëve vijojnë si mëposhtë:**

Nr.	Data e aktivitetit ndërgjegjësues	Qyteti/ Qarku	Numri I pjesëmarresve
1.	18. 03. 2015	Lezhë	27 aktorë social të Bashkisë dhe Komunave të Lezhës
2.	10. 04.2015	Durrës	43 nxënës të Shkollës së Mesme "Frrok Nikoll Kacorri"
3.	27. 04.2015	Delvine	34 nxënës të Shkollës së Mesme "Sulejman Delvina"
4.	28. 04.2015	Fushë – Krujë	20 nxënës të Shkollës së Mesme "SHote Galica"
5.	11.05.2015	Elbasan	25 nxënës të Shkollës së Mesme "Arianiti"
6.	13.05.2015	Peshkopi	16 përfaqësues të zyrave të pushtetit lokal, përfaqësues OJF-sh, besimtarë të Kishës Envangjeliste në Peshkopi etj.
7.	14.05.2015	Elbasan	46 nxënës të Shkollës së Mesme "Dhaskal Todri"
8.	20.05.2015	Fushe -Kruje	20 nxënës të Shkollës së Mesme "Adem Gjeli"
9.	22.05.2015	Fier	21 te rinj vullnetarë të Qendrës Rinore Epoka
10.	23.05.2015	Durres	13 nxënës të Shkollës së Mesme
11.	25.05.2015	Kavajë	24 mësues të shkollës 9 vjecare "Rilindja"
12.	11.06.2015	Përmet	16 nxënës të Qendrës Multifuksionale Kulturore Permet
13.	06.09.2015	Balldre/ Lezhë	13 nxënës të shkollës 9 vjecare & Shkollës së Mesme
14.	25.09. 2015	Përmet	15 persona nga Njësia Administative Piskovë
15.	25.09. 2015	Tiranë	50 nxënës të shkollës së mesme "Myslym Keta"
16.	28.09. 2015	Përmet	25 nxënës të Shkollës së Mesme
17.	29.09. 2015	Përmet	23 nxënës të Shkollave të Mesme
18.	29.09. 2015	Kucovë	23 punonjës të institucioneve kryesore lokale
19.	30.09. 2015	Nikël/ Tiranë	27 nxnënës të Shkollës së mesme " Ramazan Karaj" Nikel
20.	30.09. 2015	Përmet	23 nxënës të Shkollave të Mesme
21.	02. 10. 2015	Kukës	18 specialistë të Njësive Adminsitative të Qarkut Kukës

22.	**6.10. 2015**	**Berat**	**22 përfaqësues të insitucioneve lokale, aktivistë të shoqërisë civilë dhe nxënës të Shkollave të Mesme**
25.	9.10. 2015	Kucovë	24 nxënës të Shkollave të Mesme
26.	13.10. 2015	Sukth/ Durrës	32 nxënës të Shkollave të Mesme
29.	15.10. 2015	Lezhë	30 nxënës të Shkollës së Mesme "Karl Gega"/ Balldre
30.	18.10. 2015	Kukës	100 persona ishin pjesë e marshimit ndërgjegjësues
35.	25.10. 2015	Tropojë	18 nxënës të Shkollës 9 -Vjeçare "Ali Podrimja"
36.	27. 10. 2015	Shkodër	25 nxënës të Shkollës së Mesme "28 Nentori"
37.	28. 10. 2015	Gjirokastër	18 nxënës dhe 3 Mësues të Shkollës 9 - Vjeçare 'Cajupi"
38.	28.10. 2015	Pogradec	52 nxënës dhe mësues ndoqën shfaqen teatrale mbi trafikimin të vënë në skenë në Teatrin e Kukullave "Pirro Xeci"
39.	28.10. 2015	Lezhë	50 nxënës të Shkollës së Mesme jo publike "Ragacionistet"
40.	29.10. 2015	Vlorë	22 nxënës të Shkollës së Mesme industriale "Pavaresia"
41.	29.10. 2015	Kavajë	Shkolla e Bashkuar Gose
44.	29.10. 2015	Peshkopi	40 nxënës të Shkollave te Mesme
45.	30.10. 2015	Bulqizë	27 nxënës të Shkollave të Mesme
46.	30.10. 2015	Gjirokastër	15 nxnënës të Shkollës së Mesme"Fermi Ibrahimi"
47.	30.10. 2015	Ura Vajgurore/ Njësia Administative Kutalli	55 nxënës dhe mësues të Shkollave të Mesme

D&E është përfshirë aktivitisht në të gjitha fushatat ndërgjegjësuese të iniciuara nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave.

Kështu në kuadër të 30 Korrikut, Ditës Ndërkombëtare kundër trafikimit në përsona, D&E ju bashkua aktivitetit *"Flisni për ata që nuk munden! Raportoni trafikimin! Telefononi falas 116 006!"*.

Aktivitete të tjera ku D&E është angazhuar kanë qenë:

- ***Ekspozita me piktura në Muajin Kundër Trafikimit të Personave***

Në kuadër të aktiviteteve të organizuara gjatë Muajit Kundër Trafikimit të Personave, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave organizoi Ekspozitën e Pikturave "Trafikimi në sytë e fëmijëve", të realizuara nga fëmijët e shkollave 9-Vjeçare dhe gjimnazeve në vend, si edhe nga përfitueset që asisitohen në qendrat e KKSAT. Organizata "Të Ndryshëm dhe Të Barabartë" ka marre pjesë në këtë aktivitet me rreth 10 punime me piktura të punuara nga përfitueset, të cilat u nderuan edhe me 3 çmime nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti-trafik.

- ***Marshim sensibilizues në Ditën Europiane Kundër Trafikimit të Personave***

Më 18 Tetor, Ditën Europiane Kundër Trafikimit të Personave, stafi dhe përfitues të organizatës "Të Ndryshëm dhe Të Barabartë" iu bashkuan marshimit sensibilizues organizuar nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështjet e Luftës Kundër Trafikimit të Personave.

- ***Fushata ndërgjegjësuese përmes facebook-ut***

Organiza "Të Ndryshëm & Të Barabartë" është aktive në faqen e saj zyrtare në Facebook, duke shpërndarë vazhdimisht informacione ndërgjegjësuese mbi të drejtat e njeriut, trafikimin, skllavërinë dhe dhunën.

Organizata bëhet pjesë përmes bashkimit në fushata ndërgjegjësuese në rrjete sociale, në përkujtimin e ditëve botërore dhe europiane që lidhen me të drejtat e njeriut dhe ndërgjegjësimin mbi to, në përfshirjen indirekte të përfitueseve në këto fushata, në ndarjen e aktiviteteve të asistencës që organizata ofron, në pasqyrimin e veprimtarisë së saj dhe aktivitetet komunitare të organizuara.

- ***Përfshirje e përfitueseve në sensibilizim dhe ndërgjegjësim për luftën kundër trafikimit në persona***

Në 30 Korrik Ditën Botërore Kundër Trafikimi, përfitueset u bënë pjesë e fushatës **#igivehope** në rrjetet sociale. Ky poster është realizuar nga viktimat e trafikimit për të mbështetur viktimat e trafikimit në mbarë botën. "SHPRESE, për të gjithë ata që u është vjedhur liria, si ne..." ishte mesazhi i tyre.

- Ndërkohë në kuadër të projektit "**Informimi i komunitetit mbi trafikimin e grave dhe vajzave dhe zgjedhjet alternative"** zbatuar nga D&E dhe anëtarët e tjerë të KKSAT, me mbështetjen financiare të UN Women janë organizuar aktivitete të tjera ndërgjegjësuese të fokusuara në tre target –grupe kryesore:

1. **Forume me nxënës të shkollave të mesme në të 12 qarqet e Shqipërisë.**

Nr.	Data e forumit	Qyteti/ Qarku	Numri i pjesëmarresve
1.	6.10.2015	Tiranë	20 nxënës të Shkollës së Baletit
2.	8.10.2015	Tiranë	28 nxënës të Shkollës së Mesme "Abdulla Keta"
3.	13.10.2015	Elbasan	30 nxënës (përfaqësues të qeverisë së nxënësve) të Shkollës së Mesme "Dhaskal Todri"
4.	14.10.2015	Elbasan	27 nxënës (përfaqësues të qeverisë së nxënësve) të Shkollës së Mesme "Mahir Domi"
5.	14.10.2015	Fier	27 nxënës të Shkollës së Mesme "Janaq Kilica"
6.	14.10.2015	Shkodër	28 nxënës të Shkollës së Mesme "28 Nëntori"
7.	15.10.2015	Gjirokastër	17 nxënës të Shkollës së Mesme: "Siri Shatllo"
8.	16.10.2015	Gjirokastër	19 nxënës të Shkollës së Mesme: "Hasim Zeneli"
9.	16.10.2015	Durrës	51 nxënës (përfaqësues të qeverisë së nxënësve)të Shkollës së Mesme "Gjergj Kastrioti"
10.	16.10.2015	Berat	31 nxënës të Shkollës së Mesme "Bab Dud Karbunara"
11.	20.10.2015	Vlorë	30 nxënës të Shkollës së Mesme "Halim Xhelo"
12.	20.10.2015	Shkodër	26 nxënës të Shkollës së Mesme 'Jordan Misja'
13.	20.10.2015	Lezhë	45 nxënës të shkollës "Lezha Academic Center"
14.	21.10.2015	Korcë	54 nxënës (përfaqësues të qeverisë së nxënësve) të Shkollës së Mesme "Themistokli Gërmenji"
15.	21.10.2015	Vlorë	31 nxënës të Shkollës së Mesme 'Ali Demi"
16.	21.10.2015	Peshkopi	31 nxënës të Shkollës së Mesme të bashkuar "Maqellarë"
17.	22.10.2015	Peshkopi	27 nxënës të Shkollës së Mesme "Seit Najdeni"
18.	22.10.2015	Rrëshen	34 nxënës të Shkollës së Mesme "Shën Jozef Puntori"
19.	26.10.2015	Korcë	27 nxënës (përfaqësues të qeverisë së nxënësve)të Shkollës së Mesme "Raqi Qirinxhi"
20.	26.10.2015	Korcë	26 nxnënës (përfaqësues të qeverisë së nxënësve) të Shkollës së Mesme private "Malteze"
21.	27.10.2015	Durrës	35 nxënës (përfaqësues të qeverisë së nxënësve) të Shkollës së Mesme "Naim Frashëri"
22.	27.10.2015	Fier	30 nxënës të Shkollës së Mesme 'Perikli Konomi"
23.	29.10.2015	Berat	27 nxënës të Shkollës së Mesme "Kristaq Kapo"
24.	29.10.2015	Kukës	35 nxënës të Shkollës së Mesme "Havzi Nela"
25.	29.10.2015	Kukës	21 nxnënës të Shkollës së Mesme "Ahmet Voka\/ Gostil

2. Fokus grupe me gra dhe vajza vulnerabël në të 12 qarqet e Shqipërisë

19 fokus grupe janë organizuar me gra dhe vajza vulnerabël në qarkun e Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Beratit, Korçës, Vlorës, Fierit, Shkodrës, Lezhës.

Nr.	Data e fokus grupeve	Qyteti/ Qarku	Numri I pjesëmarresve
1.	23.11.2015	Elbasan	20 gra dhe vajza
2.	24.11.2015	Vlorë	20 gra dhe vajza
3.	25.11.2015	Tiranë	15 gra dhe vajza
4.	26.11.2015	Elbasan	31 gra dhe vajza
5.	26.11.2015	Lezhe	31 gra dhe vajza
6.	1.12.2015	Durrës	18 gra dhe vajza
7.	3.12.2015	Tirane	35 gra dhe vajza
8.	4.12.2015	Berat	23 gra dhe vajza
9.	4.12.2015	Shkodër	33 gra dhe vajza
10.	9.12.2015	Lezhë	21 gra dhe vajza
11.	10.12.2015	Korcë	18 gra dhe vajza
12.	10.12.2015	Fier	24 gra dhe vajza
13.	14.12.2015	Durrës	14 gra dhe vajza
14.	15.12.2015	Korcë	18 gra dhe vajza
15.	16.12.2015	Vlorë	24 gra dhe vajza
19.	26.12.2015	Berat	20 gra dhe vajza

3. Dialogje sociale me studentë dhe profesorë në universitetet kryesore të Shqipërisë.

Tetë dialogje sociale janë organizuar me studentë dhe profesorë në univerisitetin e Durrësit, Elbasanit, Vlorës Shkodrës, Korçës, Gjirokastrës dhe Tiranës.

Nr.	Data e dialogjeve sociale	Qyteti/ Qarku	Numri i pjesëmarresve
1.	22.10.2015	Durrës	76 studentë të degëve punë sociale, psikologji, juridik dhe infermieri/ Universiteti A. Moisiu"
2.	30.11.2015	Elbasan	150 studentë të degëve punë sociale, psikologji, infermieri dhe mësuesi/ Universiteti "A. Xhuvani"
3.	8.12.2015	Gjirokastër	45 studentë të Universitetit "Eqerem Cabej"
4.	11.12.2015	Vlorë	69 studentë të Universitetit "Ismail Qemali"
5.	15.12.2015	Tiranë	61 studentë nga Fakulteti i Shkencave Sociale/ Universiteti i Tiranës
6.	15.12.2015	Korçë	85 studentë të Universitetit "Fan Noli"
7.	17.12.2015	Shkodër	51 studentë të Universitetit "Luigj Gurakuqi"
8.	18.12.2015	Berat	38 studentë të "Albanian University"

Gjatë këtyre aktiviteteve informuese ekspertët anti –trafik përdorën metodat interaktive të tilla si: brainstorimi, leksione të shkurtra mbi rreziqet dhe implikimet e fenomenit të trafikimit në persona, shkaqet, dinamikat, rreziket, si edhe shërbimet ekzistuese për VeT/ VMT; paraqitja e versionit elektoronik te fotonovelës, pyetje dhe pergjigje gjatë sesioneve etj.

h. AKTIVITETE PËR PARANDALIMIN E DHUNËS SEKSUALE DHE TRAFIKIMIT

Universiteti i Bedfordshire në UK, mbështetur nga Council of Europe dhe OAK Foundation, po zbaton projektin "Our Voices "(2013-2016). Ky projekt europian, ka për qëllim të promovojë përfshirjen e të rinjve në përpjektjet për parandalimin e dhunës seksuale në Europë, bazuar në idetë dhe eksperiencën e Këshilluesve të Rinj që vijnë nga backgrounde të ndryshëm.
Organizata " Të ndryshëm & Të Barabartë" është nje nga organizatat e rajonit, e ftuar të bëhet pjesë e projektit dhe në vitin 2014 u përfshi me mbajtjen e tre konsultimeve me Këshilluesit e rinj. Të rinjte e përfshire, kanë qënë të ekspozuar ndaj llojeve të ndryshme të dhunës seksuale, dhe jane përfitues të organizatës.
Pas fazës së parë të projektit, Këshilluesit e Rinj u bënë pjesë e projektit, përmes ideve se si ato mund të përfshiheshin në parandalimin e dhunës seksuale. Në përfundim të fazës së parë u botua raporti që mund të gjendet në linkun e mëposhtëm http://beds.staging.squizedge.net/research-ref/iasr/centres/ourvoices/neës/2015/they-dont-talk-about-it-enough-report-on-young-peoples-views-on-sexual-violence
Aktualisht projekti është në fazën tjetër, ku idetë e Këshilluesve të Rinj mbi parandalimin e dhunës seksuale do të vihen në praktikë. Këshilluesit e Rinj të organizatës " Të Ndryshëm & Të Barabartë" kanë propozuar disa aktivitete ndërgjegjësuese në këtë kuadër. Këshilluesit e

Rinj, mbështetur nga stafi i organizatës, do të zhvillojnë 15 takime me të rinjtë në Shkolla të Mesme, qëndra rinore, dhe Universitet, takime në të cilat do të shfaqet një film i shkurtër dhe do të ndahet informacion mbi dhunën seksuale. Pjesë e projektit është dhe vendosja në Shkolla, qendra rinore dhe Universitete e një posteri të hartuar nga Këshilluesit e Rinj.

IV. TRAINIME DHE PREZANTIME TË OFRUARA NGA D&E

D&E së bashku me KKSAT organizoi Konferencën **"Ri/integrimi i Personave të Trafikuar në Shqipëri"**, pas përfundimit të projektit të financuar nga KBF. Qëllimi i kësaj Konference ishte për të diskutuar përfshirjen afatgjatë socio-ekonomik të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore me anë të prezantimit të arritjeve kryesore të Programit të Riintegrimit të Viktimave të Trafikimit në Shqipëri.

D&E ka ofruar disa prezantime këtë vit në aktivitete nderkombëtare si:

- ***Konferenca e tretë Botërore e Strehëzave të Grave,*** organizuar në Hagë, Hollandë/ në datat 3- 6 Nëntor; Prezantim me titull: ***"Riintegrimi i Viktimave të trafikimit: Çfarë mund të bëjmë më mirë?"***
- Konferenca e organizuar nga Universiteti Bedforshire për përfshirjen e të rinjve në parandalimin e dhunës seksuale, në Londer, Angli 29-30 Shtator 2015; Prezantimi me titull: ***"Stigma dhe përfaqësimi"*** në të cilin u diskutua për ide sesi projektet me pjesëmarrje mund të rrisin stigmën dhe çfarë strategjish mund të zbatohen për të minimizuar rrezikun."
- EU Workshop për Ri-integrimin e Viktimave të Trafikimit, Bruksel/ Belgjikë; -në Qershor 2015 u organizua takimi i fundit i rrjetit të partnerëve të programit të riintegrimit të viktimave të trafikimit i ngritur me mbështetjen e KBF. Prezantimi me titull ***"Asistencë riintegruese për kategoritë e viktimave që kanë pësuar lloje të ndryshme shfrytëzimi"***.
- Konferena kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore organizuar në Bled, Slloveni Prezantimi me titull: ***"Situata e Trafikimit në Shqipëri dhe Riintegrimi i Viktimave të trafikimit"***.
- Konferenca Rajonale ***"Gjenerata e Re e Ndërmarrjeve Sociale"*** ku u prezantua biznesi soacial "New York Tirana Bagels.
- Konferenca ***"Përmirësimi i shërbimeve sociale që ofrohen nga Organizata të Shoqërisë Civile në Shqipëri"***: Prezantimi me titull: ***"Shërbimet dhe Ndihma që ofrohet nga Koalicioni I Strehëzave Anti-Trafik"***.
- Konferencë ***"Adresimi i hijes së gjatë – dhuna seksuale kundrejt burrave dhe djemve", Instituti Jug –Jug, Kamboxhia;*** Prezantim me titull ***"Abuzimi seksual i djemve në Shqipëri"***
- ***"Konferencë mbi trafikimin në persona"*** organizuar nga rrjeti RENATE, Spanjë; Prezantim me titull ***"Shfrytëzimi dhe trafikimi i meshkujve në Shqipëri"***

V. PJESËMARRJA E STAFIT NË TRAINIME

- Trainim mbi ***"Ndihmën e Parë",*** organizuar nga D&E në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar;
- Trainim mbi ***"Përmirësimi i aftësive për vlerësimin profesional të përfitueseve, aftësive dhe interesave si dhe rritjen e njohurive për përfituesit e shërbimeve në lidhje me skemat ekzistuese të fuqizimit ekonomik në vend"*** organizuar nga IOM Tiranë dhe UN WOMEN;
- Trainim ***"Shërbimet sociale në Europën Juglindore",*** organizuar IRIS ACAMEDY në Kroaci;
- Trainim "***Proçesi i konsultimit dhe validimit të paketës udhëzuese për Menaxherët e rasteve"*** organizuar nga IOM Tiranë;
- Konference **"Adresimi i hijes së gjatë – dhuna seksuale kundrejt burrave dhe djemve", Instituti Jug –Jug, Kamboxhia**;
- ***" Konferencë mbi trafikimin në persona'*** organizuar nga rrjeti RENATE, Spanjë;
- ***Konferenca kundër trafikimit në persona*** organizuar nga Medaille Trust në Slloveni;
- Seminar mbi ***"Njekja penale e trafikimit në persona, eksplorimi i përqasjeve të reja"***, organizuar nga ICMPD në Vienë, Austri;
- Trainim ***"Të ndihmojmë të mbijetuarit e dhunës dhe fëmijët e tyre"***, organizuar nga UNDP;
- Vizitë Studimore e aktorëve që punojnë në fushën kundër trfikimit nga Shqipëria në Kiev, Ukrainë, organizuar nga IOM, UN.WOMEN. Objektivi kryesor i vizitës studimore ishte "R**ritja e njohurive në lidhje me aktivitetet fuqizimin ekonomik në mbështetje të viktimave të trafikimit riintegrim të qëndrueshëm"**;
- ***"Intervistimi në kontekstin ligjor i fëmijëve viktima të abuzimit seksual"*,** organizuar nga TdH Shqipëri.

VI. KOORDINIME ME AKTORË TË TJERË KUNDËR TRAFIKIMIT

- D&E ka marre pjesë aktivisht në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti –Trafik.

- Takimet e MKR, Task Forcës
- Takime të Autoritetit Përgjegjës
- Takimet koordinuese për aktivitetet në kuadër të Muajit Antitrafik

- D&E ka marrë pjesë aktivisht në të gjitha aktivitetet e organizuara nga "Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë" si dhe Agjensia për Mbrojtjen e te Drejtave të Fëmijëve:

- Takime konsultuese mbi Mbrojtjen e Fëmijëve në situate rruge;

- D&E ka marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Anti –trafik ku në këtë periudhë ka patur dhe kryesinë e koalicionit.

- D&E ka marrë pjesë në disa aktivitete të organizuara nga institucione partnere si dhe janë përgatitur disa materiale me sugjerime për përmirësimin e kuadrit ligjor. Më konkretisht janë dhënë komente dhe sugjerime për projektligjet e mëposhtme:

- Projektligji për Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile;
- Projektligji për shërbimet shoqërore;
- Projektligji për ndërmarrjet sociale;
- Konsultime për të drejtat e grave në kuadër të Reformës në Drejtësi

Përveç kësaj D&E ka punuar shumë këtë vit për të rritur marëdhëniet me biznesin dhe median.

- Bashkëpunimi me biznesin

D&E ka rritur bashkëpunimin me kompanitë e biznesit në Shqipëri për sa i përket mbështetjes për fuqizimin ekonomik të rasteve të trajtuara në programin e ri-integrimit si nëpërmjet programeve të internship-it po ashtu edhe nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim pranë këtyre kompanive.

Gjithashtu D&E ka bashkëpunuar me biznesin për mbështetje financiare ose në natyrë, sidomos për koncertin e bamirësisë që u organizua në nëntor 2015 ku shumë biznese dhuruan produkte nga kompanitë e tyre të cilat u shitën gjatë ankandit të heshtur.

- Bashkepunimi me median

D&E ka bashkëpunuar me disa media të shkruara dhe elektronike këtë vit për sa i përket ndërgjegjësimit të publikut për trafikimin dhe informimit për dhënien e ndihmës. Gjithashtu nëpërmjet bashkëpunumit me "UN Women" dhe "Ministrinë e Punëve të Brendshme" D&E së bashku me anëtarë të KKSAT ka marrë pjesë në forumin e medias, në konferencën vjetore të organizuar nga "UN Women" dhe "Ministria e Punëve të Brendshme", ku drejtore e D&E ishte edhe anëtare e jurisë të përzgjidhjes së artikujve më profesional.

Eventi i vitit për mbledhjen e fondeve – Koncert pianoje

D&E për të tretin vit radhazi ka organizuar edhe këtë vit një aktivitet për mbledhjen e fondeve. Aktiviteti që u organizua këtë vit ishte një koncert pianoje ku përformoi pianistja dhe kompozitorja gjermane Elham Payman. Koncerti u realizua pranë Ambasadës Gjermane e cila e mbështeti D&E për të dytin vit në organizimin e një eventi të tillë. Në kuadër të këtij aktiviteti D&E u mbështet edhe nga disa biznese duke ofruar produkte të ndryshme për t'u shitur gjatë ankandit të heshtur.

VII. BOTIME

- ***"Të mbajmë fëmijët të sigurt nga trafikimi: Një udhëzues për profesionistët që punojnë me të rinjtë dhe këshilluesit bashkëmoshatarë në Shqipëri".***

Ky udhëzues është botuar në kuadër të projektit "**Edukimi i komunitetit për Çështje të trafikimit në persona**" të zbatuar nga D&E dhe "Korpusi i Paqes" me mbështetjen financiare të Programit të Granteve të Komisionit për Demokraci të Ambsadës së ShBA-së, nëTiranë.

Ky udhë zues ë shtë hartuar pë r të pajisur të rinjtë me informacione dhe aftë si pë r të cilat ata kanë nevojë për të qënë të sigurt dhe anë tarë aktiv të komunitetit të tyre. Ky udhë zues mund të pë rdoret nga profesionistët që punojnë më të rinjtë, vullnetarë t e Korpusit të Paqes dhe nga mentorë t bashkë moshatarë në Shqipë ri. Udhë zuesi ë shtë një burim informativ që ju lejon të angazhoni dhe fuqizoni të rinjtë në më nyra argë tuese dhe kuptimplota.



❖ ***Reframing Trafficking prevention: Lessons from a Positive Deviance approach***

Ky botim u realizua në kuadër të projektit: "**Vulnerabiliteti ndaj trafikimit dhe faktorët e riskut: Parandalimi i trafikimit dhe mbështetja e migracionit të sigurt në komunitetet e Shqipërisë, Bosnjës, Kosovës, Maqedonisë dhe Serbisë**" zbatuar nga D&E në bashkëpunim me FAFO Norvegji dhe NEXUS Institute Washington.
Qëllimi kryesor i projektit ishte adaptimi dhe vlerësimi i metodologjisë së Deviancës Positive (PD) për parandalimin e trafikimit dhe promovimin e migracionit të sigurt. Metodologjia e Deviancës Pozitive identifikon dhe mobilizon komunitetin duke synuar arritjen e ndryshimit social.



❖ ***Preventing Human Trafficking: Positive Deviance methodology in practice***

Edhe ky botim u realizua në kuadër të projektit: "**Vulnerabiliteti ndaj trafikimit dhe faktorët e riskut: Parandalimi i trafikimit dhe mbështetja e migracionit të sigurt në komunitetet e Shqipërisë, Bosnjës, Kosovës, Maqedonisë dhe Serbisë**" zbatuar nga D&E në bashkëpunim me FAFO Norvegji dhe NEXUS Institute Washington.



❖ ***"They dont talk aboit it enough"***

Ky është një raport i shkurtër i konsultimeve të bëra me të rinjtë këshillues nga të gjitha vendet dhe partnerët e projektit "Zërat Tanë" ku Universiteti Bedfordshire është udhëheqës dhe D&E është një nga partnerët e projektit.